

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: Shtypshkrime dhe materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a” e ndarë në dy lote

- **Loti i parë: “Shtypshkrime për nevojat e OSHEE Group sh.a dhe bijave”;**
- **Loti i dytë: “Materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a dhe bijave”;**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): materiale te ndryshme te shtypura.

VLERA E FONDIT LIMIT: 59,994,530 (pesëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH ose 594,829.7 (pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind e njëzet e nëntë pikë shtatë) euro pa tvsh, sipas kursit te kembimit te BSH 1euro= 100.86 all.

Loti i parë: “Shtypshkrime për nevojat e OSHEE Group sh.a dhe bijave” me vlerë fondi limit 37,265,100 (tridhjetë e shtatë milion e dyqind gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind) lekë pa TVSH ose 369,473.5 (treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre pikë pesë) euro pa tvsh;

Loti i dytë: “Materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a dhe bijave” me vlerë fondi limit 22,729,430 (njëzet e dy milion e shtatëqind njëzet e nëntë mijë e katërqind tridhjetë) lekë pa TVSH ose 225,356.2 (dyqind e njëzet e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë dy) euro pa tvsh;;

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE Group Sh.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te jete me dy lote .

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (LOTI I) me objekt “Shtypshkrime për nevojat e OSHEE Group sh.a dhe bijave”;

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2. 1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **100%** e vlerës së përlogaritur të kontratës LOTIT I, që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë llojin e mallrave dhe koheshtrirjen e kontrates për këtë objekt procedure prokurimi, kerkohet që OE ofertues të deshmojë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kerkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim është kërkuar vërtetim i xhiros për tre vitet e fundit në një vlerë jo më e vogël se **100%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet .

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”*.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së përlogaritur të kontratës /te lotit të pare, që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të

thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 35 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilësinë e mallrave të kërkuar në këtë objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar me kontrata të ngjashme, të jete afer limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK krijon siguri dhe besueshmëri që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi me sukses dhe pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.4.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

a) Certificate ISO 9001 për sistemin e menaxhimit të cilësisë, **OSE EKUIVALENTE** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

b) Certificate ISO 14001 për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor, **OSE EKUIVALENTE** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Gjithashtu, këto certificate janë të nevojshme për të vërtetuar që operatori ekonomik ofertues ushtron aktivitet në pajtueshmëri me standardet e kërkuara të cilësisë dhe të menaxhimit Mjedisor në raport me objektin e kontratës që do të realizohet sipas standarteve ndërkombëtare ISO.

2.4.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej **minimalisht 5 persona për muajin e fundit të maturuar në datën e hapjes së ofertave**. Për plotësimin e kësaj kërkesë, operatori ekonomik duhet të dorëzojë

një vërtetim për numrin e punonjësve të lëshuar nga Administrata Tatimore që vërteton se subjekti ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për muajin e fundit të maturuar në datën e hapjes së ofertave, shoqëruar me listëpagesën e dorëzuar pranë organeve tatimore për muajin e fundit të maturuar në datën e hapjes së ofertave.

Për përmbushjen e këtij kriteri në fazën e ofertimit, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST.

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).*

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përllogaritur duke marrë në konsideratë sasinë e mallrave të kërkuara objekt i kësaj kontrate, duke pasur parasysh edhe afatin e levrimit dhe të shpërdarjes së materialeve sipas specifikimeve teknike. Gjithashtu theksojmë se shtypshkrimet të cilat do të prodhohen sipas formateve të kërkuara, kërkojnë linje prodhimi rrjedhimisht edhe punonjes përkatës. Po ashtu janë kërkuar edhe dy mjete të cilat do të bëjnë transportin dhe shpërndarjen sipas adresës të përcaktuara në specifikime, për të cilat kërkohet gjithashtu personel.

2.4.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- **Makinë shtypi offset me minimalisht 3 (tre) ngjyra dhe format minimal 42 x 30 cm**
- **Makinë palosje format minimal 42 x 30**
- **Makinë për numërim**
- **Makinë për mbledhjen automatike të letres**
- **Makinë qepëse me tel,**
- **Makinë qepëse me pe**
- **Pajisje CTP për parapergatitje për shtyp**

Operatori ekonomik për të vertetuar disponimin e pajisjeve të mesipërme duhet të paraqesë dokumentacionin në një nga formatet e mëposhtme:

- Kontrata shitblerje/ Fatura shitblerje, ose
- Kontrata huapërdorje, ose
- Kontrata qiramarrje, ose
- kontrata e dhurimit.

Në rast se posedon makinerinë/te me qira ose huapërdorje, duhet të paraqesë kontratën e qirase ose huapërdorjes të lidhur mes paleve, me afat kohezgjatje minimalisht dy muaj vlefshmeri).

Argumentim: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Kërkohen këto pajisje me qëllim prodhimin e shtypshkrimeve të cilat parashikohen të prodhohen nepermjet linjes teknologjike prodhuese. Të gjitha llojet dhe formatet e makinerive dhe pajisjeve të kerkuara janë në përputhje të plote me kërkesat dhe specifikimet teknike të mallrave/shtypshkrimeve që kërkohen të furnizohen.

2.4.4 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të provojë se disponon minimalisht **2 makina transporti** në pronësi ose me kontratë qeraje me afat kohezgjatje për të gjithë kohën e vazhdimësisë së kontratës, për këtë duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës sipas legjislacionit në fuqi

Mjetet e transportit duhet të jenë të pajisura me dokumentacion përkatës sipas legjislacionit në fuqi (certifikatë pronësie, leje qarkullimi, sigurim mjeti dhe certifikate të kontrollit teknik të mjetit).

Për të përmbushur kriteret (2.4.3 dhe 2.4.4) të mesipërme në fazën e ofertimit, operatori ekonomik duhet të deklarojë disponimin e makinave në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Sqarim : Përmbushja e këtij kriteri në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, siç parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur

kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit me qellim shperndarjen e mallrave ne adresat e kerkuara ne DT.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe levrimin e mallrave. Keto mjete kerkohen per te realizuar shperndarje e materialeve sipas adreses te percaktuar ne DT.

II- KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PER LOTIN E DYTE ME OBJEKT “MATERIALE ARKIVE PËR NEVOJAT E OSHEE GROUP SH.A DHE BIJAVE”;

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **100%** e vlerës së përlogaritur të kontratës LOTIT II, që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Duke marre ne konsiderate llojin e mallrave dhe koheshtrirjen e kontrates per kete objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te deshmoje se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim eshte kerkuar vertetim i xhiros per tre vitet e fundit ne nje vlere jo më e vogël se **100%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet .

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13 pika 2: “*Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi*”.

2.2.2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin

kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilanci e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së përlogaritur të kontratës /te Lotit të Dytë, që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- d) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 35 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

-
- e) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate sasine dhe cilesine e mallrave te kerkuar ne kete objekt procedure prokurimi, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete realizuar me kontrata te ngjashme, te jete afer limitit maksimal dhe ne kete menyre, AK krijon sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi me sukses dhe pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme me objekt të njëjtë me objektin e prokurimit si më poshtë:

- ISO 9001 ose ekuivalent (për Sistemin e Menaxhimit të Cilesisë) e *(vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
- ISO 14001 ose ekuivalent (për Menaxhimin e Ambjentit) e *(vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
- ISO 45001 ose ekuivalent (për Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në punë) e *(vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
- ISO 16245 ose ekuivalent (për prodhimin e kutive dhe të materialeve të tjera, me baze celuloze, për ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve) e *(vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Certifikimi me ISO 9001 është i nevojshëm, kjo në respektim të nenit 30, pika 1, e VKM 914 date 29.12.2014 i ndryshuar, autoriteti mund të kërkojnë ISO 9001 e vlefshme për menaxhimin e cilesise.

Certifikimi me ISO 14001 për menaxhim mjedis, është e nevojshme për shkak se disponimi i saj verteton qe OE ofertues në proceset e tij të prodhimit implementon të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit, masa keto aprovohen nga institucione të pavarura certifikuese.

Certifikimi me ISO 45001 për menaxhim mjedis, është e nevojshme për shkak se disponimi i saj verteton qe OE ofertues në proceset e tij të prodhimit implementon të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit, masa keto aprovohen nga institucione të pavarura certifikuese.

Certifikimi me ISO 16245 është i nevojshëm, kjo pasi vërteton që OE ofertues në procesin e prodhimit respekton me rigorozitet dhe plotëson të gjitha masat e nevojshme për prodhimin e kutive dhe kapakeve të perbera nga material celuloze, të cilat përdoren për arkivimin e dokumenteve shkresore për një periudhë të gjatë kohe.

2.4.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej **minimalisht 10 persona për muajin e fundit të maturuar në datën e hapjes së ofertave**. Për plotësimin e kësaj kërkesë, operatori ekonomik duhet të dorëzojë një vërtetim për numrin e punonjësve të lëshuar nga Administrata Tatimore që vërteton se subjekti ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për muajin e fundit të maturuar në datën e hapjes së ofertave, shoqëruar me listëpagesën e dorëzuar pranë organeve tatimore për muajin e fundit të maturuar në datën e hapjes së ofertave.

Për përmbushjen e këtij kriteri në fazën e ofertimit, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST.

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

2.4.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) dizajner që të ketë mbaruar shkollën e lartë. Kjo të vërtetohet me diplomën e shkollës së lartë, kontratën e punës si edhe certifikatën përkatëse që vërteton se punonjësi ka njohuri në fushën e grafik-dizajnit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Argumentim: *Duke marrë parasysh volumin e mallrave të kerkuar nga Ak dhe periudhën e prodhimit të tyre si edhe teknologjinë dhe proceset e punës me të cilat këto mallra përgatiten, është kerkuar një minimum numri punonjësish, numer i cili garanton që prodhimi të kryhet në kohën e duhur pa ndikuar në cilësinë e tij.*

Argumentim: *Duke u nisur nga fakti se të gjithë artikujt e kerkuar kërkojnë një përgatitje paraprake të dizajnit nga një specialist i familjarizuar me kërkesat që një material duhet të ketë që të quhet i gatshëm për shtyp, kërkesa për një specialist designer me diplomë universitare është e nevojshme dhe mbi të gjitha që të jete një person që gjithashtu ka specializim në fushën e grafikes*

per shkak se pjesa me e madhe e artikujve kane te bejne me pergatitjen e formave per prerje. Standartet nderkombetare te prodhimit ne fushen e shtypshkrimeve apo marketingut kerkojne nje pune teper e sakte dhe duhet qe personi i cili e kryen kete pune te jete nje specialist edhe ne fushen e pictures dhe ne ate te grafikes.

2.4.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

•Makinë shtypi 50x70 5 C + llak ose me përmasa më të mëdha

•Makinë qepse me pe me permasa 35x25

•Makinë prerje me permasa 80x110

•Makine qepese me tel

•Thikë një anëshe

- **Formatet e këtyre makinave janë formatet minimale, mund të paraqiten makina me formate më të mëdha.**
- Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore, kontrata blerje/dhurim, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji. Për makineritë me qira duhet të paraqese kontraten e qirase ose huaperdorjes te lidhur mes paleve, me afat kohezgjatje minimalisht dy muaj vlefshmeri, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësin (fatura tatimore, kontrate blerje/dhurimi, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji).

Per te permbushur kriterin e mesiperm ne fazen e ofertimit, operatori ekonomik duhet deklaroje disponimin e makinave ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Sqarim : Përmbushja e këtij kriteri në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur

kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit me qëllim shpërndarjen e mallrave në adresat e kerkuara në DT. *Duke analizuar të gjitha proceset e punës të cilat duhet të kryhen për prodhimin e materialeve të kerkuara nga AK, është llogaritur një numër minimal makinerish posedimi i të cilave garanton që OE ofertues ka kapacitetet teknike që të kryejë punën e kërkuar.*

2.4.5 Autoriteti kontraktor i lind e drejta të verifikojë disponimin e makinerive dhe ambienteve të shtypshkronjës. Deklarate nga Administratori i shoqërisë.

2.4.6 Garancia e mallrave të furnizuar duhet të jetë jo më pak se 24 muaj. Të paraqitet Deklarate për Garancinë.

2.4.7 Në datën dhe orën e hapjes së tenderit duhet të paraqitet në cilesinë e mostres:

- *Një kuti kartoni me permasa 40x28x18 ;*
- *Një Kutë për ruajtje të përhershme me permasa 40x28x18;*

sipas specifikimeve të përcaktuara në DST.

Argumentim: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, përsa i përket ofertës teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta për kualifikim janë hartuar nga struktura e posaçme e ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor.